

**MEMORANDUM I MIRËKUPITIMIT NË FUSHËN E KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE**

NDËRMJET

**AGJENCISË PËR KOMUNIKIME ELEKTRONIKE DHE POSTARE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

DHE

**AUTORITETIT RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS**

Agjencia për Komunikime Elektronike dhe Postare e Republikës së Shqipërisë (AKEP) dhe Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit i Republikës së Kosovës (ART), që më tej ju referohemi me termin “Palët”,

Me qëllim të **vazhdimësisë** së mëtutjeshme të marrëdhënieve miqësore mbi bazën e barazisë dhe përfitimit të ndërsjellë,

Duke **ditur** rëndësinë e komunikimeve elektronike në zhvillimin e mirëqenies shoqërore dhe ekonomike të të dyja vendeve

Duke konsideruar:

- a. Bazën e përbashkët për planet dhe programin dhe gatishmërinë për të mbajtur kontakte të rregullta dhe për të zhvilluar bashkëpunim praktik në çështjet që kanë të bëjnë me shërbimet e komunikimeve elektronike,
- b. Përfitimet që mund rriten edhe për AKEP edhe për ART nga bashkëpunimi midis dy autoriteteve rregullator në çështjet që kanë të bëjnë me shkëmbimin e informatave, përvojës dhe dokumenteve mbi zhvillimin e shërbimeve të komunikimit elektronik në të dyja vendet.

Të **bindur** në nevojën dhe dëshirën për bashkëpunim më të gjerë ndërmjet dy autoriteteve,

Palët e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit pajtohen të bashkëpunojnë me qëllim të shkëmbimit të përvojës dhe informatave si vijon:

Neni 1

Palët do të shkëmbejnë rregullisht, informata sa i përket zhvillimit të politikave dhe strategjive për komunikimet elektronike në shtetet e tyre.

Neni 2

Palët gjithashtu do të shkëmbejnë rregullisht, informata sa i përket ligjeve dhe rregulloreve të komunikimeve elektronike në nivel shtetëror, duke përfshirë edhe amendamentet dhe modifikimin e tyre.

Neni 3

Palët do të shkëmbejnë të gjitha të dhënat publike informata mbi aktivitetet në tregjet e komunikimeve elektronike shtetërore. Të dhënat e siguruar do të përditësohen në baza vjetore.

Neni 4

Shkëmbimi i delegacioneve të ekspertëve mund të bëhet në baza të rregullta ose, sipas nevojës, *ad-hoc*, për studimin e aspekteve teknike, ligjore dhe aspekteve tjera të aktiviteteve të rregullatorit shtetëror.

Neni 5

Palët, kur është e përshtatshme, do të informojnë dhe do të informojnë dhe do të ftojnë njëra tjetrën në simpoziume dhe konferenca ndërkombëtare të organizuara nën organizimin e tyre.

Neni 6

Zyrtarët e lartë të Palëve do të takohen në baza të rregullta për t'u konsultuar sa i përket rishikimit dhe implementimit të këtij Memorandumi, në mënyrë që të vendosin prioritetet e bashkëpunimit përbrenda kësaj kornize për vazhdimin e të njëjtit, dhe shkëmbimin e pikëpamjeve dhe, ato, sipas nevojës, do të ndërmarrin veprime dhe pozicione të përbashkëta në forume dhe organizata evropiane dhe ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me sektorin e komunikimeve.

Neni 7

Palët do të shqyrtojnë në baza dyvjetore, rezultatet e bashkëpunimit të tyre sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit. Sipas nevojës, Palët do të ndërmarrin hapa për përmirësimin e bashkëpunimit dhe do të bëjnë propozime të përshtatshme për të ndryshuar fushëveprimin e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit.

Neni 8

Dispozitat e këtij Memorandumi nuk janë të detyrueshme për Palët, dhe si të tilla, nuk do të interpretohen si marrëveshje sipas ligjeve ndërkombëtare dhe nuk do të kenë të drejta dhe obligime në fushën e legjislacionit ndërkombëtar.

Neni 9

Me pëlqimin e të dyja Palëve, amandamentimet dhe shtojcat mund të inkorporohen në këtë Memorandum, të dokumentuara si protokolle, të cilat përbëjnë pjesën integrale të këtij Memorandumi.

Neni 10

Ky Memorandum i Mirëkuptimit hyn në fuqi nga data e poshtëshënuar dhe mund të ndërpritet nga secila Palë, duke njoftuar Palën tjetër paraprakisht në afat kohor prej një (1) muaji.

Ky memorandum nuk ka për qëllim të jetë kufizues por sa i përket llojeve të bashkëpunimit, të cilat mund të jenë të mundshme në mes AKEP dhe ART. Parashikohet që ky Memorandum të ndryshohet kohë pas kohe, nëse rrethanat ndryshojnë dhe paraqiten mundësi të reja, me qëllim të fillimit të një aktiviteti të përbashkët. Me nënshkrimet e tyre të mëposhtme, përfaqësuesit e AKEP-it dhe ART-së bien dakord për të ecur përpara në ndërtimin e marrëdhënieve bashkëpunuese, përmes veprimtarive të përbashkëta, të përshkruara në dispozitat e neneve të lartshënuara, ose të tjera, për të cilat pajtohen kohë pas kohe.

Nënshkruar më datë, 22 Mars, 2010 në Prishtinë, në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe në dy kopje në gjuhën angleze, ku të gjitha tekstet do të jenë ekuivalente me originalin, përgatitur në gjuhën shqipe.

Në rast të ndonjë papajtueshmërie mes versioneve, për qëllime të interpretimit të drejtë të këtij Memorandumi, versioni i shkruar në gjuhën angleze do të merret parasysh.

Në emër të Agjencisë së Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Republikës së Shqipërisë

Piro Xhixho
Kryetar i Këshillit Drejtues /
Drejtor Ekzekutiv

Në emër të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacioni të Republikës së Kosovës

Ekrem Hoxha
Kryetar i Bordit/Drejtor Ekzekutiv